



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE  
BORDI I ADMINISTRIMIT**

**VENDIM**

**Nr. 35 , datë 29/09/2020**

**MBI**

**“MIRATIMIN PARAPRAK, PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË  
CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË BACHELOR  
“PERKUSION”, TË PARAQITUR NGA DEPARTAMENTI I INTERPRETIMIT,  
PRANË FAKULTETIT TË MUZIKËS NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr. 41, datë 24/01/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” (i ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18/12/2019); Udhëzimin e MASR nr. 1, datë 14/01/2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë”; Vendimin e Senatit Akademik nr. 40, datë 25.09.2020 “Mbi miratimin paraprak, për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor ‘Perkusion’, të paraqitur nga Departamenti i Interpretimit, pranë Fakultetit të Muzikës”; si dhe në shkresën e datës 25.09.2020, të Kryetarit të Senatit Akademik të Universitetit të Arteve, Prof. Kastriot Çausi, me lëndë “Përcjellje të Vendimeve të Senatit Akademik”, drejtuar Bordit të Administrimit së UART dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi dokumentacionin e paraqitur nga FM, me votim të hapur,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin paraprak të dokumentacionit për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor ‘Perkusion’, të paraqitur nga Departamenti i Interpretimit, pranë Fakultetit të Muzikës në Universitetin e Arteve, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim të dërgohet për miratim përfundimtar pranë MASR, sipas Pikës 4, Kreut VI të Udhëzimit nr. 1, datë 14/01/2020 nga Përgjegjësi i Njesisë Bazë Interpretim, në Fakultetin e Muzikës të Universitetit të Arteve.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti i Muzikës të Universitetit të Arteve.
4. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe te transparenca.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

